

# REPUBLIKA E SHQIPERISE PROFILI I MIGRACIONIT



IOM International Organization for Migration



REPUBLIC OF SLOVENIA  
MINISTRY OF THE INTERIOR

**Tetor 2007**





---

IOM International Organization for Migration  
ONM Organizata Ndërkombëtare për Migracionin

# REPUBLIKA E SHQIPERISE

## Profili i Migracionit

Botimi i këtij materiali në shqip u realizua nga:  
Zyra e IOM në Shqipëri

**Përgatitur nga:** Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM)

**Botues:** Ministria e Brendshme e Republikës së Sllovenisë

**Kopertina:** Boris Teodorović

**Formati:** Branka Derenčin

**Tirazhi i Botimit të Pare:** 120 kopje

**Shtypshkronja:** Mond grafika, d. o. o

Tekst i pabotuar

Ljubljana, Shtator 2007

## **Përgatitur nga**

Alin Chindea  
Magdalena Majkowska-Tomkin  
Isabel Pastor

## **Mirënjohje**

Kjo seri botimesh është rezultat i bashkëpunimit me një pjesë të stafit të IOM-it dhe specialistëve të tjerë. Falenderime të veçanta për Christine Aghazarm, Saskia Buschman-Petit, Sanja Celebic Lukovac, Veronica Escudero, Teuta Grazhdani, Jacqueline Koster, Balazs Lehel, Biljana Nastovska, Miriam Neziri, Anna Eva Radicetti, Sarah Schwarz, Jovana Skrjug, Suna Skupnjak-Kapic, Mariko Tomiyama, Dusica Zivkovic, Kasia Zaremba, Branka Zulj dhe gjithë stafit tjetër të IOM-it . Edhe pse nuk janë përmëndur me emra, shumë falenderime shkojnë edhe për të gjithë ata punonjës, në administratat e tyre përkatëse, të cilët na ofruan informacion të vlefshëm.

Shumë mirënjohje edhe për Qeverinë e Sllovenisë që mundësoi financimin e këtij studimi.

## Hyrje

Modelet dhe tendencat e migracionit kanë pasoja të rënda për kushtet demografike, ekonomike dhe sociale. Studimi i këtyre tendencave dhe modeleve kërkon përgjegjshmëri dhe planifikim në nivele kombëtare.

Duke pasur parasysh sa më sipër, si dhe faktin që Sllovenia do të marrë Presidencën e radhës në BE gjatë gjysmës së parë të vitit 2008 ku përfshihet edhe axhenda e migracionit, qeveria Sllovene mori iniciativën t'i kërkojë IOM-it të hartojë “profilin e migracionit” ( sikurse është ashtuquajtur edhe nga Komisioni European) për Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Kroacinë, ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Republikën e Malit të Zi, Republikën e Serbisë dhe Turqinë.

Kjo sipërmarrje përforcon përpjekjet e KE-së për të adresuar migracionin në kuptimin më të gjerë të fjalës, në partneritet me vendet e treta. Ky studim është në përputhje me parimet e BE-së për Trajtimin Global të Migracionit<sup>1</sup> dhe në veçanti përgatit terrenin për veprime konkrete në përputhje me Komunikatën e Komisionit European për Zbatimin e Strategjisë Globale të Migracionit në vendet Lindore dhe Juglindore që aspirojnë për në Bashkimin European, të muajit Maj 2007.<sup>2</sup>

Ky dokument u përgatit nga Organizata Ndërkombëtare për Migracionin ( IOM ) në Korrik dhe Gusht 2007 dhe është bazuar në informacione, të dhëna, analiza dhe komente publikisht të disponueshme, si dhe në informacione të vetë IOM-it.

Dokumentet e “profilin të migracionit “ paraqesin një përmbledhje ad hoc të të dhënave ekzistuese të vjela nga burime të ndryshme duke përfshirë edhe qeveritë e këtyre vëndeve; organizata dhe trupa ndërkombëtare; raporte studimore akademike të pavarura; si dhe burime dhe informacione të brendshme të IOM-it. Si i tillë, ky studim, nuk mund të jetë as përfundimtar dhe as të nxjerrë konkluzione.

Të gjitha burimet janë cituar. Për sqarime mbi përkufizimet, lexuesi mund t'i referohet burimit origjinal të informacionit që mund të jetë më shumë se një. Larmia e madhe e burimeve mund të çojë në mospërputhje, që vjen si rezultat i mënyrave të ndryshme të mbledhjes së të dhënave, përkufizimeve dhe datave të referencës që përdoren.

Rrethanat kombëtare ndryshojnë nga një vend në tjetrin përse i përket strukturave ekzistuese institucionale, kuadrit legjislativ dhe strategjik, si dhe qasjeve metodologjike.

---

<sup>1</sup>Konkluzionet e Presidencës për Trajtimin Global të Migracionit: Priority actions focusing on Africa and the Mediterranean, European Council, Brussels, 15-16 December 2005.

<sup>2</sup>Komunikata e KE-së (“COM(2006) 735 final) The Global Approach to Migration one year on: Towards a comprehensive European integration policy.

Në përgjithësi, në të gjitha shtetet vihet re një kuadër i fragmentuar institucional kombëtar si p.sh disa institucione dhe zyra që merren me hartimin dhe regjistrimin e informacioneve që lidhen me migracionin si edhe organizata dhe organizma të tjerë ndërkombëtare që janë prezentë në pjesën më të madhe të këtyre vendeve. Rezultatet nxjerrin në pah nevojën e pashmangshme të një marrëveshjeje për të unifikuar përkufizimet dhe metodologjinë për regjistrimin e informacioneve mbi emigracionin dhe imigracionin. Një problem i përgjithshëm është mungesa e të dhënave të disponueshme. Por edhe kur të dhënat ekzistojnë, niveli i ulët i standartizimit, përsa i përket terminologjisë dhe metodologjisë, rezulton në nivele të ndryshme mospërputhshmërie.

Pavarësisht mungesës dhe mospërputhshmërisë të të dhënave të disponueshme, shpresojmë se ky studim do të rrisë ndërgjegjësimin për çështjet e migracionit në këto vende dhe do të ofrojë informacion të rëndësishëm për zhvillimin e politikave.



© CIA World Factbook.

<b>Shqipëria – Fakte kryesore</b>	
Popullsia (2005)	3,154.00
Sipërfaqja e përgjithshme	28.748 km <sup>2</sup>
PBB për frymë, fuqia blerëse	4.978 USD
Renditja e Indeksit të Zhvillimit Njerëzor	73 nga 177
Raporti i Migracionit Neto	-6.5 migrantë/1,000 popullsi
Burimet: Departamenti i Kombeve të Bashkuara për Çështjet Ekonomike dhe Sociale, Prospekte mbi Popullsinë Botërore për Ndarjen e Popullsisë: Rishikim i bankës së të dhënave të Popullsisë për vitin 2006. Raporti i Programit për Zhvillimin të Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin Njerëzor për vitin 2006.	

## TABELA E PERMBAJTJES

<b>1. IMIGRANTET</b> .....	11
1.1. Numri i imigrantëve.....	11
1.2. Statusi i imigrantëve.....	11
1.3. Shtetet kryesore të origjinës së imigrantëve.....	11
<b>2. EMIGRANTET</b> .....	12
2.1. Numri i emigrantëve.....	12
2.2. Statusi i emigrantëve.....	12
2.3. Shtetet kryesore të destinacionit.....	13
2.4. Emigracioni Meshkuj/Femra .....	13
2.5. Sektorët kryesorë të këtij aktiviteti.....	14
<b>3. DERGESAT NE PARA TE MIGRANTEVE</b> .....	15
3.1. Aspektet sasiore të dërgesave në para të migrantëve.....	15
3.2. Aspektet cilësore të dërgesave në para të migrantëve .....	15
3.3. Numri i familjeve që mbahen nga dërgesat në para të migrantëve.....	16
<b>4. KOMUNITETET E MIGRANTEVE / DIASPORA</b> .....	17
4.1. Përshkrim i marrëdhënjes midis diasporave dhe shteteve të origjinës.....	17
4.2. Organizatat e komuniteteve te migranteve/diasporave.....	17
<b>5. MIGRACIONI I PARREGULLT</b> .....	20
5.1. Përlllogaritje/vlerësime të lëvizjeve të parregullta.....	20
5.2. Shifra dhe informacion mbi flukset e migrantëve të kthyer.....	21
<b>6. VLERESIMI DHE ANALIZIMI I ÇESHTJEVE TE MIGRACIONIT</b> .....	22
6.1. Vlerësim përmbledhës i çështjeve të migracionit.....	22
6.2. Institucionet qeveritare përgjegjëse për politikat e migracionit.....	23
6.3. Politikat ekzistuese të migracionit .....	24
6.4. Kuadri ligjor ndërkombëtar në lidhje me migracionin.....	27
6.5. Përqindja e “ikjes së trurit” dhe politikat përkatëse.....	28
6.6. Rrugët e paligjshme të migracionit dhe politikat për migracionin e parregullt.....	29
6.7. Trafikimi i qenieve njerëzore dhe politikat përkatëse.....	29
6.8. Refugjatët, azil- kërkuesit dhe personat e zhvendosur brenda vendit dhe politikat ekzistuese.....	31
6.9. Projektet dhe programet për migracionin dhe zhvillimin.....	32
6.10. Aktorë të tjerë të rëndësishëm në fushën e migracionit në vend.....	33

## LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Shtetet Kryesore të Destinacionit për Emigrantët Shqiptarë.....	12
Tabela 2: Sasia e dërgesave në para të migrantëve e shprehur në milion USD.....	15
Tabela 3: Dërgesat në para të migrantëve si përqindje e PPB.....	15
Tabela 4: Shtetasit shqiptarë që janë kapur në 25 shtete të BE-së (2003-2005).....	20
Tabela 5: Shtetasit shqiptarë të kapur sipas shteteve në 2003.....	20
Tabela 6: Migrantët e parregullt të ndaluar në Shqipëri.....	20
Tabela 7: Shtetasit e vendeve të treta të cilëve i'u është refuzuar hyrja në Shqipëri.....	20
Tabela 8: Migrantët të parregullt të ripranuar në Shqipëri nga shtetet e tjera.....	21

# 1. IMIGRANTET

## 1.1. Numri i imigrantëve

[Të dhënat nga Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit të Shqipërisë ]

----- 3.814(2006)<sup>1</sup>

## 1.2. Statusi i imigrantëve

Refugjatë-----56 (2006)<sup>2</sup>

Azil-kërkues -----36 (2006)<sup>3</sup>

Migrantë për punë

Leje pune të lëshuara-----857 (2006)<sup>4</sup>

Leje banimi të lëshuara-----3.006 (2006)<sup>5</sup>

## 1.3. Shtetet kryesore të origjinës së imigrantëve

[Të dhënat nga Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit]<sup>6</sup>

SHBA, Itali, Kinë, Turqi dhe Greqi

[Të dhënat nga Banka Botërore]<sup>7</sup>

Republika Çeke, Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Greqia, Izraeli, Italia, Serbia dhe Mali i Zi, Rusia.

---

<sup>1</sup>Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit, Shqipëri [2006] Shifra i referohet numrit të të huajve me leje qëndrimi në 2006 plus numrit të migrantëve të parregullt të pajisur me urdhër largimi.

<sup>2</sup>UNCHR[2006]: Statistical Yearbook (Libri Vjetor i Statistikave) për Vitin 2006. Tendencat Globale: Refugjatë, Azil-kërkues, Të kthyer, Persona të shpërngulur brënda vendit dhe Persona pa Shtetësi. Shifrat pasqyrojnë statistikat e fundit të vitit 2006. Të dhënat janë paraprake dhe që mund të ndryshojnë. Statusi si i 15 Qershor 2007. Shifra i referohet “persona të percaktuar si refugjatë sipas Konventës së KB 1951/ Protokoll 1967, Konventa OAU e vitit 1969, në përputhje me Statutin e UNHCR-së, persona që iu është dhënë një formë plotësuese mbrojtjeje dhe atyre që iu është dhënë mbrojtje e përkohshme”.

<sup>3</sup>UNHCR [2006] Libri i Statistikave i vitit 2006. Tendencat Globale: Refugjatë, Azil - kërkues, Të kthyer, Persona të shpërngulur brënda vëndit dhe persona pa shtetësi. Shifrat pasqyrojnë statistikat e fundvitit 2006. Të dhënat janë paraprake dhe që mund të ndryshojnë. Statusi si i 15 Qershor-it 2007. Shifra i referohet Personave aplikimi i të cilëve për “ azil me status refugjati” është në pritje të te gjitha fazave te procedurave për azil.

<sup>4</sup>Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Shqipëri [Gusht 2007].

<sup>5</sup>Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit , Shqipëri [2006].

<sup>6</sup>Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit , Shqipëri [2006].

<sup>7</sup>Banka Botërore, Grupi i Zhvillimit të Perspektivës [2005]: Libër të dhënash mbi Migracionin dhe Dërgesat në para të migrantëve.

## 2. EMIGRANTET

### 2.1. Numri i emigrantëve

-----860.485 (2005, Banka Botërore)<sup>8</sup>  
 Si përqindje e popullsisë së përgjithshme-----27% (2005, Banka Botërore)<sup>9</sup>  
 Raporti gjinor-----75% meshkuj, / 25% femra<sup>10</sup>  
 (INSTAT, Instituti Shqiptar i Statistikave)<sup>11</sup>

**Tabela 1:** Shtetet Kryesore të Destinacionit për Emigrantët Shqiptarë

Shteti	Numri	Viti	Burimi
Greqi	434.810	2003	Raporti Vjetor i Komisionit Europian mbi Statistikat e Migracionit, Azilit dhe Kthimeve <sup>12</sup>
Itali	348.813	2006	ISTAT Zyra Italiane e Statistikave <sup>13</sup>
SHBA	113.661	2000	Regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë në SHBA <sup>14</sup>
Mbretëria e Bashkuar	50.000	2005	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale, Punësimit dhe Shanseve të Barabarta, Shqipëri <sup>15</sup>
Kanada	14.935	2001	Regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë në Kanada
Gjermani	11.630	2002	Zyra Federale e Statistikave <sup>16</sup>

### 2.2. Statusi i emigrantëve

Refugjatë - - - - - 14.080 (2006)<sup>17</sup>  
 Azil-kërkues- - - - - -2.258 (2006)<sup>18</sup>  
 Përqindja e emigrantëve me edukim terciar - - - - - -20% (2005)<sup>19</sup>

<sup>8</sup>Banka Botërore, Grupi i Zhvillimit të Perspektivës [2005]: Factbook për Migracionin dhe Dërgesat në para të migrantëve.

<sup>9</sup>Ibid.

<sup>10</sup>Instituti Shqiptar i Statistikave (INSTAT) [2002]: Regjistri i përgjithshëm i popullsisë për 2001.

<sup>11</sup>Komisioni Europian [2003]: Raporti Vjetor i Statistikave për Migracionin, Azilin dhe Kthimin.

<sup>12</sup>ISTAT (Zyra Italiane e Statistikave) [2007]: Popolazione straniera residente per area geografica e principali paesi di cittadinanza, al 1 Gennaio 2007.

<sup>13</sup>Census Bureau i SHBA [2000]: www.census.gov.

<sup>14</sup>De Zwager, N., Gedeshi, I., Germeji, E., Nikas, C., IOM Tirana [2005]: Konkurenca për dërgesat në para të migrantëve.

<sup>15</sup>Statistikat për Kanadanë [2001]: http://www.statcan.ca.

<sup>16</sup>Zyra federale e Statistikave për Gjermaninë [2002]: http://www.destatis.de.

<sup>17</sup>UNCHR [2006]: Libri Vjetor i Statistikave 2006. Drejtimit Globale: Refugjatë, Azil-kërkues, Të kthyer, Persona të shpërngulur brënda vendit dhe pa shtetësi. Shifrat pasqyrojnë statistikën e fundvitit 2006. Të dhënat janë paraprake dhe mund të ndryshojnë. Statusi si ai i 15 Qershor-it 2007. Shifra i referohet "personave të percaktuar si refugjatë" sipas Konventës së KE të vitit 1951 /Protokollit të vitit 1967, Konventa OAU e vitit 1969, në përputhje me Statutin e UNHCR, personave që i'u është dhënë një formë plotësuese për mbrojtjen e tyre dhe atyre që i'u është dhënë mbrojtje e përkohshme.

<sup>18</sup>UNCHR [2006]: Libri i Statistikave i Vitit 2006. Tendencat Globale: Refugjatë, Azil-kërkues, Të kthyer, Persona të shpërngulur brënda vendit dhe Persona pa shtetësi. Shifrat pasqyrojnë statistikën e fundit të vitit 2006. Të dhënat janë paraprake dhe që mund të ndryshojnë. Statusi si ai i Qershorit 2007. Shifra i referohet personave aplikimi i,

## 2.3. Shtetet kryesore të destinacionit

Austria, Kanadaja, Franca, Gjermania, Greqia, Italia, Mbretëria e Bashkuar, Shtetet e Bashkuara, Turqia<sup>20</sup> (Referojuni seksionit 2.1. për numrat në shtetet e përzgjedhura të destinacionit).

## 2.4. Emigracioni meshkuj/femra

Numri i femrave shqiptare që emigrojnë ka ardhur duke u rritur gjatë viteve të fundit, si rezultat i bashkimeve familjare. Ky është një ndryshim i rëndësishëm i modelit bashkëkohor të migracionit shqiptar në krahasim me atë të mëparshëm ku predominonin meshkujt. Statistikat në lidhje me rregullimin dhe regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë në Greqi dhe Itali, që janë dy destinacionet kryesore për migrantët shqiptarë që nga vitet 1990-të, tregojnë se në fillim dhe në gjysmën e parë të viteve 1990-të përbënin rreth 20% të totalit të migracionit shqiptar, ndërsa, në vitet 2000-01 ato përbënin 40% të migrantëve<sup>21</sup>. Sipas regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë të vitit 2001 në Greqi, 59% e shtetasve shqiptarë në Greqi ishin meshkuj. Të dhënat bazuar në lejet e qëndrimit të lëshuara në vitin 2004 (viti më i fundit për të cilin kishte të dhëna të disponueshme) tregojnë se 77% e aplikantëve ishin burra<sup>22</sup>.

Pjesa më e madhe e grave kanë emigruar si pjesë e familjes, ose bashkë me familjen (veçanërisht emigrimi në SHBA nëpërmjet programit të Llotarisë Amerikane (Diversity Visa Programme), ose në Kanada nëpërmjet programit të Vizave për Punëtorë të Kualifikuar (Skilled Worker Visa Programme), ose janë bashkuar me bashkëshortet/të fejuarit e tyre pasi ata janë rregulluar në shtetin pritës. Pjesa më e madhe e femrave (beqare) të cilat kanë emigruar vetëm, kanë shkuar në këto vende për të ndjekur studimet e tyre në vende të ndryshme të BE-së si edhe në SHBA. Numri i grave beqare që emigrojnë jashtë shtetit për punë në rrugë ligjore është ende i vogël, dhe kryesisht janë gra të profesionalizuara dhe me kualifikim të lartë, zakonisht gra nga familje me të ardhura mesatare dhe të larta<sup>23</sup>.

---

të cilëve për "Azil ose status refugjati është në pritje të të gjitha fazave të procedurave për azil.

<sup>19</sup>Banka Botërore, Grupi i Zhvillimit të Perspektivës [2005]: Libër të dhënash mbi Migracionin dhe Dërgesat në para të migrantëve, sipas Docquier and Marfouk [2004] dhe Docquier dhe Bhargava [2006].

<sup>20</sup>Banka Botërore, Grupi i Zhvillimit të Perspektivës [2005]: Libër të dhënash mbi Migracionin dhe Dërgesat në para të migrantëve.

<sup>21</sup>Russell K., Vullnetari, J., Qendra Kërkimore Sussex për Migracionin [2003]: Migracioni dhe Zhvillimi në Shqipëri, Fletë Pune Nr. C5.

<sup>22</sup>Ministria e Brendshme, Greqi, Departamenti i Emigracionit Social, 30/08/2004. ([http://www.antigone.gr/statistics/residence\\_permits\\_all\\_types.htm](http://www.antigone.gr/statistics/residence_permits_all_types.htm))

<sup>23</sup>Russell K., Vullnetari, J., Qendra Kërkimore Sussex për Migracionin [2003]: Migracioni dhe Zhvillimi në Shqipëri, Fletë Pune Nr. C5.

## 2.5. Sektorët kryesorë të aktivitetit

Sektorët kryesorë të punësimit për emigrantët shqiptarë meshkuj në Greqi janë ndërtimi (49%) dhe bujqësia (21%). Ndërsa në Itali sektorët primare për meshkujt janë ndërtimi (43%), puna në fabrika (19%) dhe shërbimet (16%). Në të dy këto vende fqinjë gratë kryesisht bëjnë punë shtëpie. Në Mbretërinë e Bashkuar, ndërtimi dhe shërbimet janë dy sektorët kryesorë të punës për burrat ( përkatësisht 33% and 32% ), ndërsa për gratë sektori i shërbimeve duket se është ai më “ i preferuari”(66%)<sup>24</sup>.

---

<sup>24</sup>De Zwager, N., Gedeshi, I., Germenji, E., Nikas, C., IOM Tirana [2005]: Konkurenca për dërgesat në para të migrantëve.

### 3. DERGESAT NE PARA TE MIGRANTEVE

#### 3.1. Aspektet sasiore të dërgesave në para të migrantëve

**Tabela 2:** Sasia e dërgesave në para të migrantëve e shprehur në milion USD

Viti	Banka Botërore <sup>25</sup>	Banka Kombëtare e Shqipërisë <sup>26</sup>
2003	889	778
2004	1161	1028
2005	1290	1161
2006	1359	Mungesë të dhënash

**Tabela 3:** Dërgesat në para të migrantëve si përqindje e PPP

Viti	Banka Botërore <sup>27</sup>	Banka Kombëtare e Shqipërisë <sup>28</sup>
2003	14,5%	13%
2004	15,4 %	13,7%
2005	15,4%	14%
2006	14,8%	Mungesë të dhënash

#### **Dërgesat në para të migrantëve nga shtetet pritëse në Shqipëri (ata që sigurojnë dërgesat në para):**

Greqia (60%), Italia (30%), të pasuara nga SHBA, Gjermania dhe shtete të tjera Europiane<sup>29</sup>.

#### 3.2. Aspektet cilësore të dërgesave në para të migrantëve

Sasia e dërgesave në para të migrantëve në Shqipëri është tre herë më e lartë se investimet e huaja direkte dhe pothuajse dy herë më shumë se sa ndihmat zyrtare për zhvillim që i janë dhënë Shqipërisë<sup>30</sup>. Migrantët shqiptarë zakonisht i dërgojnë paratë me mënyra jo formale (77.4%) – kryesisht dorazi; dhe më pak me rrugë formale (22.6%) – sistemi nëpërmjet bankës vazhdon të mbetet mënyra më pak e preferuar<sup>31</sup>. Për arsye të afërsisë gjeografike, Shqiptarët që jetojnë në Greqi apo Itali, vijnë mesatarisht 2-3 herë në vit në Shqipëri dhe i sjellin ato me vete.

<sup>25</sup>Banka Botërore, Grupi i Zhvillimit të Perspektivës [2005]: Libër të dhënash mbi Migracionin dhe Dërgesat në para të migrantëve.

<sup>26</sup>Banka e Shqipërisë [2004]: Prezantim në IMF në Qershor 2006  
<http://www.imf.org/external/np/sta/bop/2006/luxgrp/pdf/albani.pdf>

Banka llogarit dërgesat në para të migrantëve si diferenca midis monedhës së huaj që hyn në vend dhe monedhës së huaj që del. Kjo llogaritje nuk përfshihet mundësinë e përfshirjes edhe të të ardhurave nga aktivitete të dyshimta, siç është trafikimi.

<sup>27</sup>Banka Botërore, Grupi i Zhvillimit të Perspektivës, [2005]: Libër të dhënash mbi Migracionin dhe Dërgesat në para të migrantëve, llogaritjet e veta të bazuara në të dhënat e Bankës Botërore.

<sup>28</sup>Banka e Shqipërisë [2004]: Prezantim në IMF në Qershor 2006  
<http://www.imf.org/external/np/sta/bop/2006/luxgrp/pdf/albani.pdf>

<sup>29</sup>Banka Botërore [2006]: Korridori i Remitancave Itali-Shqipëri.

<sup>30</sup>Instituti i Politikave Sociale [2007]: Report për iniciativat ekzistuese mbi rregulloren e shkëmbimit të monedhës së huaj dhe investimit në Shqipëri. Disponohet në [www.iomtirana.org.al](http://www.iomtirana.org.al).

<sup>31</sup>Banka Botërore [2006]: Korridori i ndihmave financiare Itali-Shqipëri... afërsisë gjeografike shqiptarët që jetojnë në Greqi apo Itali vijnë mesatarisht 2-3 herë në vit në Shqipëri dhe i sjellin ato me vete.

Operatorët e Transferimit të Parave dominojnë tregun formal të transferimit të parave nga Italia në Shqipëri<sup>32</sup>. Operatorët e Transferimit të Parave kanë avantazhe në krahasim me bankat, siç është shërbimi i shpejtë i transferimit, dhe dërguesit nuk e kanë si kusht që të kenë llogari bankare. Përveç kësaj, personat marrës në Shqipëri nuk kanë shumë akses në sektorin bankar. Rezultatet e një studimi të kryer nga IOM-i për familjet e migrantëve në Shqipëri në vitin 2005, tregojnë se ato nuk e njohin mirë sistemin bankar në Shqipëri. Vetëm 45.3% e familjeve kanë llogari bankare. Dhe nëse merren parasysh edhe familjet që jetojnë në zonat rurale, atëhere përqindja është edhe më e ulët<sup>33</sup>.

Në përgjithësi, faktorët që vijnë më poshtë duket se kufizojnë transfertën formale të dërgesave në para të migrantëve në Shqipëri: vështirësia që kanë migrantët për të patur akses në sektorin bankar në shtetin pritës, shpejtësia relativisht e ulët e transfertës bankare, besimi i pakët në shërbimin bankar shqiptar që kanë dërguesit dhe marrësit e parave, tarifat e larta të transfertës dhe fuqia e shkëmbimit valutor informal në tregun Shqiptar<sup>34</sup>.

### **3.3. Numri i familjeve që jetojnë në varësi të dërgesave në para të migrantëve**

68.6% e migrantëve dërgojnë para në Shqipëri. Personat marrës kryesisht janë prindërit e dërguesit, pastaj bashkëshortët dhe fëmijët, e të afërm të tjerë më të largët. Dërgesat në para përdoren kryesisht për nevojat e përditshme të familjes, për ndërtime, për rikonstruktivimin dhe mobilimin e shtëpive si dhe investimet për pasuri të patundshme.

Sipas rezultateve të Living Standard Measuring Survey (LSMS) në vitin 2002, dërgesat në para të emigrantët përbëjnë 13% të të ardhurave mesatare të familjes, ndërsa për familjet marrëse ato përbëjnë 47% të të ardhurave të familjes. Sasia mesatare e dërgesave mujore mujore ishte 13,600 Lek or USD 95 (IMF, 2005)<sup>35</sup>.

---

<sup>32</sup>Banka Botërore [2006]: Korridori i ndihmave financiare Itali-Shqipëri..

<sup>33</sup>De Zwager, N., Gedeshi, I., Germenji, E., Nikas, C., IOM Tirana [2005]: Konkurenca për dërgesat në para të emigrantëve.

<sup>34</sup>Ibid.

<sup>35</sup>Ibid.

## 4. KOMUNITETET E MIGRANTËVE/ DIASPORA

### 4.1. Përshkrim i marrëdhënies midis diasporës dhe vendit të origjinës

Nën përgjegjësinë e Ministrisë të Punëve të Jashtme, Instituti Kombëtar i Diasporës është struktura shtetërore përgjegjëse për politikën që lidhet me Diasporën Shqiptare.

Në veçanti, ky Institut ka përgjegjësitë e mëposhtme:

- Të mbrojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve shqiptarë jashtë shtetit;
- Të hartojë politika për promovimin jo vetëm të diasporave të vjetra shqiptare por edhe atyre të reja;
- Të përcaktojnë programe për marrëdhënjet dhe bashkëpunimin midis Shqipërisë dhe komuniteteve shqiptare jashtë vendit;
- Të bëjnë studime mbi zhvillimet dinamike të komuniteteve jashtë shtetit;
- Të inkurajojnë dhe përkrahë ngritjen e grupeve/shoqatave të veçanta të migrantëve shqiptarë, mbi bazën e interesave të përbashkëta, profesioneve dhe vendndodhjes gjeografike;
- Të mbështetë ngritjen e qendrave kulturore shqiptare në shtetet pritëse ku ka komunitete të mëdha shqiptare;
- Të hartojë politika për mësimin e gjuhës amtare nga fëmijët e diasporës.

Drejtor: Z. Flamur Gashi

Email: fgashi@mfa.gov.al

Tel: +355 4 232882

### 4.2. Komunitetet e migrantëve/organizatat e diasporës

(Ju lutemi kini parasysh që listës së mëposhtme mund t'i shtohen emra të tjerë. IOM-i nuk mban përgjegjësi për saktësinë e detajeve të kontaktit).

#### *Ndërkombëtarë:*

- Alb-Shkenca Forum, për akademikë nga diaspora,  
[alb-shkenca@alb-net.com](mailto:alb-shkenca@alb-net.com), <http://www.alb-shkenca.org/>
- Albstudent (Rrjeti Ndërkombëtar i Shoqatave të Studentëve)  
<http://www.albstudent.net/>
- Albanians - Today (Lajme dhe Informacion)  
<http://www.alb-net.com/mailman/listinfo/albanians-today>

#### *Greqia* <sup>36</sup>:

- Klubi Kulturor i Migrantëve Shqiptarë, 121 Irakleous St, 176 72 Kallithea, Tel.: 210-9571224

---

<sup>36</sup> Më shumë informacion mund të merret përmes Ambasadës Shqiptare në Athinë në adresën: [www.mfa.gov.al](http://www.mfa.gov.al)

- Forumi i Migrantëve Shqiptarë në Greqi, 35 Valtetsiou St, 106 81 Exarheia, Tel.: 210 381 3928
- Shoqata Shqiptare e Selanikut Tel.: 2310 556349
- Shoqata Kulturore Shqiptare “AETOS” Tel.: 6942 992866
- Klubi i Shkrimtarëve Migrantë Shqiptarë ‘DRITA’ Tel.: 210 958 2538
- Shoqata e Migrantëve Shqiptarë ‘VELAZERIMI’ Tel.: 210 271 9271
- Gazeta Shqiptare Gazeta e Athinës 3 Polytechniou St, Tel.: 210 524 3987
- Shoqata e Miqësisë Greko - Shqiptare – Socrates, Kapodstriou 38, Athens, **elassocrates@diavatirio.net, www.diavatirio.net**

### ***Itali*** <sup>37</sup>:

- Faqet e Verdha Shqiptare (një drejtori e bizneseve dhe organizatave shqiptare në Itali) **<http://www.paginegiallealbanesi.it/>**
- Lidhja e Shoqatave Shqiptare në Itali **<http://www.legalbanese.com/>**
- Egnatia-Shoqatë Shqiptare në Emilia - Romania **<http://www.egnatia.org/>**
- P. I. A. T. (Shoqatë për Promovimin e Integritimit të Shqiptarëve në Trentino) **[www.apiat.tk](http://www.apiat.tk)**
- Shoqata Kulturore “Brezi i Ri Shqiptar” në Genoa **[albandaci@hotmail.com](mailto:albandaci@hotmail.com)**
- Shoqata e Miqësisë Italo-Shqiptare Onlus of Rimini-E-mail: **[italbarimini@libero.it](mailto:italbarimini@libero.it)** **<http://digilander.libero.it/italbarimini/>**
- Shoqata Socio-Kulturore “DEA” në Pisa – **<http://www.dea-associazione.com>**
- Qendra Kulturore Shqiptare “Madre Teresa” -Via XX Settembre, 81/a -14100 Asti -Tel: 0141 324134
- Vatra – Shoqatë e intelektualëve shqiptarë në Genoa - **[vatra@interfree.it](mailto:vatra@interfree.it)**

Listën e plotë mund ta gjeni në adresën: **<http://www.arbitalia.it/cultura/associazioni.htm>**

### ***Shtetet e Bashkuara:***

- Lidhja Qytetare Shqiptaro –Amerikane **<http://www.accl.com>**
- Organizata Kombëtare Shqiptaro-Amerikane **<http://www.aano.org/>**
- Shoqata e Grave Shqiptaro-Amerikane **<http://www.aawomq.org>**
- Rrjeti i Informacionit Frosina (me bazë në Boston) **<http://www.frosina.org>**
- Këshilli Kombëtar Shqiptar Amerikan **<http://www.nacc.org>**

### ***Mbretëria e Bashkuar:***

(Lista është hartuar nga Ambasada Shqiptare në Mbretërinë e Bashkuar)  
**<http://www.albanianembassy.co.uk/page9.html>**

---

<sup>37</sup>Për më shumë informacion kontaktoni me Ambasadën shqiptare në Romë si dhe Konsullatën e Përgjithshme në Milano dhe në Bari, të dyja adresat në dispozicionin tuaj në: **[www.mfa.gov.al](http://www.mfa.gov.al)**

- Shoqata Anglo-Shqiptare Tel:02086740800
- Fondacioni Shqiptar Etnik Qëndror (MEAF) [www.meaf.org.uk](http://www.meaf.org.uk)
- Komuniteti Shqiptar “FAIK KONICA” E-mail: [bashkshqipfk@yahoo.com](mailto:bashkshqipfk@yahoo.com)
- “DITURIA” [www.dituria.ik.com](http://www.dituria.ik.com)
- Qendra Rinore Shqiptare [www.albanianyouthaction.org.uk](http://www.albanianyouthaction.org.uk)
- Shoqata Artistiko-Kulturore “EDITH DURHAM”, web: [www.edithdurham.com](http://www.edithdurham.com)
- Shoqata “SKËNDËRBEU” (SCANDERBEG ASSOCIATION)
- E-mail: [albengskenderbeu@hotmail.com](mailto:albengskenderbeu@hotmail.com)
- Shoqata “ARDHMËRIA”, [www.ardhmeria.co.uk](http://www.ardhmeria.co.uk)

Në kuadër të një projekti ekzistues që synon të rrisë zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin , IOM në Tiranë do t'i sigurojë ndihmë teknike Institutit të Diasporës për të krijuar një databazë të përditësuar ku do të reflektohen të gjitha shoqatat shqiptare jashtë shtetit në vitin 2007.

## 5. MIGRACIONI I PARREGULLT

### 5.1. Përlllogaritje/vlerësime të lëvizjeve të parregullta

**Tabela 4:** Shtetasit Shqiptarë që janë kapur në 25 shtete të BE-së (2003-2005)<sup>38</sup>

2003	2004	2005
41.789	36.965	52.365

*Burimi: Komisioni European, 2006.*

**Tabela 5:** Shtetasit Shqiptarë të kapur sipas shteteve në vitin 2003<sup>39</sup>

Greqi	34.882
Itali	4.086
Slloveni	139

**Tabela 6:** Migrantët e parregullt të ndaluar në Shqipëri<sup>40</sup>

Viti	Numri
2005	82
2006	16

*Burimi: Ministria e Brendshme, Shqipëri.*

**Tabela 7:** Shtetasit e vendeve të treta të cilëve i'u është refuzuar hyrja në Shqipëri<sup>41</sup>

Viti	Numri i shtetasve të vendeve të treta të cilëve i'u është refuzuar hyrja në Shqipëri
2003	448
2004	94
2005	510
2006	2884

*Burimi: Ministria e Brendshme, Drejtoria e Policisë Kufitare dhe Migracionit, Shqipëri.*

<sup>38</sup>Komisioni European [2006] Raporti i dytë vjetor për zhvillimin e një politike të përbashkët mbi imigracionin illegal, kontrabandizmin dhe trafikimin e qënjeve njëzëzore, kontrollin e kufijve të huaj, dhe kthimin e personave që banojnë në mënyrë të paligjshme.

<sup>39</sup>Komisioni European [2003]: Report Vjetor për Azilin dhe Migracionin [http://ec.europa.eu/justice\\_home/doc\\_centre/asylum/statistics/doc\\_annual\\_report\\_2003\\_en.htm](http://ec.europa.eu/justice_home/doc_centre/asylum/statistics/doc_annual_report_2003_en.htm).

<sup>40</sup>Të dhënat e mëposhtme kanë të bëjnë me përgjigjen që IOM i dha kërkesës së DG JLS për "informacion dhe analizim të flukseve kryesorë migruese që mund të zbulohen në rajonet lindore dhe juglindore në kufi me Bashkimin European me synimin që të identifikojnë rrugët kryesore të hyrjes së paligjshme në shtetet e BE-së dhe shtetet kryesore të origjinës", 15 Shkurt 2007.

<sup>41</sup>Të dhënat e mëposhtme kanë të bëjnë me përgjigjen që IOM i dha kërkesës së DG JLS për "informacion dhe analizim të flukseve kryesorë migruese që mund të zbulohen në rajonet lindore dhe juglindore në kufi me Bashkimin European me synimin që të identifikojnë rrugët kryesore të hyrjes së paligjshme në shtetet e BE-së dhe shtetet kryesore të origjinës", 15 Shkurt 2007.

**Tabela 8:** Migrantët e parregullt të ripranuar në Shqipëri nga shtetet e tjera<sup>42</sup>

Viti	Numri i Shqiptarëve	Numri i të Huajve
2003	34.533	35
2004	18.012	101
2005	56.043	Nuk ka të dhëna
2006	28.362	35

*Burimi: Ministria e Brendshme, Shqipëri*

## 5.2. Shifra dhe informacion mbi flukset e migrantëve të kthyer

Në vitin 2003, u dëbuan me forcë nga territori i BE-së 39,663 persona me kombësi shqiptare. Sllovenia dhe Norvegjia, edhe pse nuk janë anëtarë në BE, regjistruan një numër relativisht të lartë dëbimesh (Sllovenia 118 dhe Norvegjia 225)<sup>43</sup>. Në vitin 2006 Drejtoria e Policisë Kufitare dhe Migracionit regjistroi 42,254 raste të personave të dëbuar me forcë (me marrëveshje ripranimi dhe kthimi) dhe 15,879 të tjerë, pa pasur një marrëveshje formale ekzistuese me shtetin dërgues<sup>44</sup>.

Nga viti 2002 deri në 2006, 3,079 individë u kthyen në Shqipëri nëpërmjet programeve të IOM-it për kthimin vullnetar të asistuar, ku grupet më të mëdha që u kthyen vinin nga Mbretëria e Bashkuar (2,138), Bosnja dhe Herzegovina (328) dhe Belgjika (306)<sup>45</sup>. Një numër i madh shqiptarësh kthehen gjithashtu në mënyrë spontane për shkak të karakterit qarkullues të migracionit Shqiptar në shtetet fqinjë.

---

<sup>42</sup>Ibid.

<sup>43</sup>Ibid.

<sup>44</sup>Ministria e Brendshme e Shqipërisë [2006]. Analiza e punës së kryer nga Drejtoria e Policisë për Kufirin dhe Migracionin gjatë vitit 2006 dhe detyrat për të ardhmen.

<sup>45</sup>IOM AVR database.

## 6. VLERËSIMI DHE ANALIZIMI I ÇËSHTJEVE TË MIGRACIONIT

### 6.1. Vlerësim përmbledhës i çështjeve të migracionit

Migracioni është një nga fenomenet më të rëndësishme sociale dhe ekonomike që ka përfshirë vendin tonë në dekadën e fundit. Që nga viti 1990, pothuajse tre çereku i popullsisë shqiptare u largua nga vendi së bashku me një migracion të madh urban-rural. Faktori kryesor që shkaktoi migracionin shqiptar ishte permbysja e regjimit socialist në Europën Qëndrore dhe Lindore pas vitit 1989. Për faktin se i'u ishte mohuar e drejta për të emigruar, dhe në situatën e një politike të paqëndrueshme dhe një rënieje ekonomike, shumë shqiptarë zgjodhën emigracionin si alternativë. Në prag të zgjedhjeve të para demokratike në 1991, rreth 20,000 shqiptarë kaluan detin Adriatik me anije për në Itali. Një tjetër fazë e emigracionit masiv ishte ajo e vitit 1996-1997 pas zgjedhjeve të vitit 1996 dhe rënjes së "skemave piramidale" në të cilat shqiptarët humbën kursime me vlerë 1.2 miliardë USD (rreth gjysmën e GDP-së së vëndit) si dhe prishja e ligjit dhe rendit publik<sup>46</sup>. Në vitin 1999 më shumë se gjysëm milionë refugjatë Kosovarë mbërritën në Shqipëri. Që nga viti 2000 situata politike në vend është stabilizuar edhe pse akoma vazhdon fluksi i migracionit.

Migracioni në Shqipëri është një strategji esenciale në përpjekjen për të siguruar jetesën, sepse Shqipëria është një nga vendet më të varfëra të Europës me të ardhura rreth 2,570 (2005)<sup>47</sup> USD për frymë dhe 25.4% e popullsisë jeton nën nivelin mesatar të varfërisë<sup>48</sup>. Shqipëria është një nga shtetet me emigracion ku dërgesat në para (remitancat) përbëjnë burimin më të madh të shkëmbimit të huaj valutor, dhe që rezultojnë të jenë më të larta se investimet e huaja direkte dhe vlera e eksportit.

Shtetet kryesore të destinacionit për migrantët shqiptarë janë shtetet fqinjë Greqia dhe Italia për shkak të afërsisë së tyre gjeografike dhe kulturore si dhe ekspozimi i gjithanshëm i shoqërisë shqiptare ndaj ndikimit kulturor të këtyre shteteve (Siç është TV Italian); të pasuara nga SHBA dhe Mbretëria e Bashkuar. Greqia është destinacioni i preferuar për shqiptarët nga jugu dhe juglindja, zona që janë të populluara kryesisht me shqiptarë të krishterë Ortodoks dhe me etnikitet grek. Ndërsa Italia është destinacioni i preferuar për shqiptarët e zonave qendrore dhe perendimore. Emigracioni masiv i shqiptarëve ka përfshirë një pjesë të konsiderueshme të popullsisë aktive në ekonominë e vëndit, shumica meshkuj (regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë i vitit 2001 tregoi se rreth tre të katërtat e emigrantëve shqiptarë ishin meshkuj në moshë të re). Bashkimet familjare janë arsyeja kryesore e emigrimit të grave nga Shqipëria, duke pasqyruar modelin patriarkal të familjes. Emigrantët shqiptarë kanë prirjen për tu arsimuar me mirë krahasuar me ata që nuk migrojnë.

---

<sup>46</sup>Russell K., Vullnetari, J., Qendra Kërkimore Sussex per Migracionin [2003]: Migracioni dhe Zhvillimi në Shqipëri, Fletë Pune Nr. C5.

<sup>47</sup>Banka Botërore [2005]. <http://go.worldbank.org/QSMTKY2TE0>

<sup>48</sup>Banka Botërore [2003]. Vlerësimi i Varfërisë në Shqipëri.

Migracioni i parregullt nga (dhe përmes) Shqipërisë mbetet ende një problem ndërsa 240,000 shqiptarë u legalizuan në Greqi vetëm në periudhën 1997-1998<sup>49</sup>. Shumica e migracionit shqiptar është lokalizuar në sektorët informale të ekonomisë dhe që nuk kërkojnë kualifikim (emigrantët shqiptarë meshkuj punojnë kryesisht në ndërtim ose bujqësi ndërsa gratë në punë shtëpie), ka karakter qarkullues dhe gjithmonë për arsye ekonomike.

## 6.2. Institucionet qeveritare përgjegjëse për politikën e migracionit

Sipas një vendimi të fundit të Këshillit të Ministrave të Shqipërisë<sup>50</sup>, **Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPCSSHB)** është autoriteti përgjegjës për koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe të Planit korrespondues të Veprimit. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (ku përfshihet Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Shërbimi Social Shtetëror dhe struktura të tjera të linjës) është gjithashtu përgjegjëse për politikën migracionit për punësim në Shqipëri, si për shtetasit e vet ashtu dhe ata të huaj si dhe për lidhjen e marrëveshjeve për punësim sezonal me shtetet e tjera. **Drejtoria për Politikën e Migracionit** në këtë Ministri është struktura përgjegjëse në Shqipëri për menaxhimin dhe politikën e migracionit. Shërbimi Kombëtar i Punësimit është struktura kryesore përgjegjëse për politikën e punësimit në nivel kombëtar, bashkë me zyrat rajonale të cilat merren me problemet në zonat e tyre. Zyrat rajonale janë gjithashtu përgjegjëse për të marrë kërkesat për migracion për arsye punësimi jashtë shtetit.

<http://www.mpcs.gov.al>

**Ministria e Brendshme (MB)** përbën një nga aktorët kryesorë në fushën e migracionit në vend. Në veçanti, **Drejtoria e Policisë Kufitare dhe Migracionit** është përgjegjëse për kontrollin e kufirit, parandalimin dhe ndalimin e aktiviteteve të paligjshme që kryhen përmes kufijve shtetërorë. Përveç kësaj kjo drejtori mbikqyr lehtësimin e lëvizjeve të ligjshme të personave, mallrave e mjeteve si dhe përpunimin në kohën e duhur të dokumenteve për të huajt, grumbullimin dhe analizimin e të dhënave që përpunohen në kufirin shtetëror, dhe është përgjegjëse për zbatimin e marrëveshjeve të ripranimit midis Shqipërisë dhe shteteve të tjera. Gjatë vitit 2007, MB në bashkëpunim me aktorë të tjerë qeveritarë dhe jo-qeveritarë kanë hartuar Strategjinë Kombëtare për Manaxhimin e Integruar të Kufirit dhe Planin e Veprimit, i cili për momentin po rishikohet nga Këshilli i Ministrave.

[www.moi.gov.al](http://www.moi.gov.al)

**Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ)** është një aktor tjetër i rëndësishëm në fushën e menaxhimit të migracionit në Shqipëri. Nën përgjegjësinë e Ministrit të Punëve të Jashtme, Instituti Kombëtar i Diasporës është struktura qeveritare përgjegjëse për politikën në lidhje me diasporat shqiptare. Përveç kësaj, Ministria e Punëve të Jashtme është përgjegjëse për koordinimin e negociatave dypalëshe midis Shqipërisë dhe shteteve të tjera në nivel politik<sup>51</sup>.

---

<sup>49</sup>OECD [2007]: International Migration Outlook.

<sup>50</sup>Vendim Nr. 425, datë 11.7.2007.

<sup>51</sup>Kini parasysh se MFA kishte një rol më të kufizuar gjatë negociatave me BE-në, të cilat i drejtoi dhe koordinoi Ministria e Integritimit për vetë rolin drejtues të kësaj ministrie në negociatat për marrëveshjen

<http://www.mfa.gov.al/english/>

Instituti Kombëtar i Statistikave (INSTAT) është ngarkuar me detyrën e krijimit të Regjistrimit Kombëtar për Migracionin<sup>52</sup>.

<http://www.instat.gov.al/>

### 6.3. Politikat ekzistuese të migracionit

Kuadri i politikave për menaxhimin e migracionit në Shqipëri përbëhet nga dokumentet e politikave të mëposhtme:

#### *a) Plani i Veprimit për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizimit Asociimit*

Në 12 Qershor 2006, Shqipëria nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizimit Asociimit (MSA) me BE, e cila përbën një hap të rëndësishëm përpara për marrëdhëniet e Shqipërisë me BE-në. Vendi në këto momente po përballet me sfidën e zbatimit me sukses të Marrëveshjes së Stabilizimit Asociimit, që kërkon një reformë shumë ambicioze politike, administrative dhe ekonomike. Qeveria shqiptare e ka vendosur integrimin në BE në krye të axhendës dhe ka përcaktuar një sërë prioritetesh edhe në fushën e Çështjeve të Brendshme e të Drejtësisë; të cilat pasqyrohen në Planin e Veprimit për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizimit Asociimit<sup>53</sup>. Këto prioritete (për periudhën 2006 – 2009) vënë theksin në nevojën për të përmirësuar kapacitetet administrative dhe financiare për zbatimin e legjislacionit për azilin dhe migracionin, dhe në veçanti për zbatimin e strategjive kombëtare dhe planet korresponduese të veprimit<sup>54</sup>. Në këtë kontekst, zbatimi i plotë i Strategjisë Kombëtare për Migracionin (SKM) dhe Plani i Veprimit Kombëtar (PVK) mbeten objektivi kryesor.

#### *b) Strategjia Kombëtare për Migracionin*

Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani Kombëtar i Veprimit për Migracionin u hartuan në 2004-2005 me ndihmën e Komisionit Europian dhe IOM-it<sup>55</sup>.

Qëllimi i Strategjisë është që t'i ofrojë Shqipërisë një politikë gjithëpërfshirëse për migracionin, nga një strategji që kryesisht ishte përqëndruar në luftën kundër flukseve të parregullta, në një strategji me praktikë që bazohet në menaxhimin e migracionit. Plani i Veprimit përbën një nga hapat e parë për të bërë konkrete idenë e bashkërendimit të menaxhimit të migracionit dhe zhvillimit të një vendi të origjinës në përputhje me orientimet e politikës së përbashkët të BE-së.

<sup>52</sup>MSA me Komunitetin Europian. Negociatat me BE-në dhe specifikimi i tyre do të shtjellohen më me hollësi në seksionin.

<sup>53</sup>Qeveria e Shqipërisë [2005]: Përgjigje Pyetesorit të IOM-it për Workshop-in për Migracionin e Punësimit në Shkurt 2005, Zagreb.

<sup>54</sup>Nënkapitulli 3.24 Bashkëpunimi në Çështjet e Brendshme e të Drejtësisë, Seksioni 3.24.3. Menaxhimi i Kufirit dhe Seksioni 3.24.4 për Politikën e Migracionit.

<sup>55</sup>Zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Migracionit, 2. Ratifikimi dhe zbatimi progresiv i konventave ndërkombëtare në fushën e migracionit.

Këto materiale mund të gjeni në adresën [www.iomtirana.org.al](http://www.iomtirana.org.al)

Theksi vihet më shumë në menaxhimin e flukseve të emigracionit të cilat konsiderohen si prioritet imediat, sesa në zhvillimin e një politike për imigracionin, pasi Shqipëria me siguri do të vazhdojë të jetë për një periudhë të caktuar kohe një vend emigracioni. Megjithatë, strategjia e inkorporon imigracionin në pjesët që kanë të bëjnë me kuadrin ligjor dhe institucional në bazë të raportit paraardhës “Analiza e Legjislacionit dhe Praktikës të Imigracionit Shqiptar e Krahasuar me Analizën e Mangësive të Standarteve Ndërkombëtare të BE-së mbi Menaxhimin e Migracionit”, të hartuar nga IOM-i.

Plani i Veprimit përmbledh fushat e mëposhtme kryesore: adresimi i shkaqeve kryesore të migracionit, mbrojtja e të drejtave të emigrantëve shqiptarë jashtë shtetit, përmirësimi i shërbimeve konsullore nga ambasadat dhe konsullatat shqiptare dhe mbështetja që ato u japin komuniteteve shqiptare jashtë shtetit. Ai parashikon gjithashtu një seri masash që kanë si qëllim që të rrisin lëvizjen e migrantëve, sidomos në shtetet fqinje. Plani i Veprimit përcakton me hollësi, për secilën nga 66 masat për të cilat është rënë dakort, të gjithë elementet e nevojshëm për zbatimin e tij (objektivat, aktivitetet, kushtet që kërkohen, strukturat politike përgjegjëse dhe strukturat zbatuese, burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare, afatet dhe fazat kohore të mundshme).

Edhe pse deri tani janë bërë përpjekje nga qeveria dhe struktura të tjera përgjegjëse për të inkurajuar zbatimin e këtij Plani Veprimi, pjesa më e madhe e dispozitave të Planit Kombëtar të Veprimit nuk janë zbatuar dhe mbetet ende shumë për të bërë. Rezultatet paraprake të vlerësimit të bërë nga Instituti European në Tiranë në vitin 2006 tregojnë se jo të gjithë zyrtarët e qeverisë në ministrinë që merren me çështjet e migracionit janë në dijeni të përmbajtjes së kësaj strategjie<sup>56</sup>. Kjo është kryesisht si rezultat i mungesës së një strukture qendrore përgjegjëse për koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit. Instituti i Diasporës u krijua në Ministrinë e Punëve të Jashtme me detyrën për të konceptualizuar dhe koordinuar politikat për migracionin, imigracionin dhe diasporat; megjithatë ky Institut nuk ka kapacitet<sup>57</sup> për të kryer këtë funksion. Përveç vështirësive të koordinimit, angazhimi financiar i qeverisë për të dhënë fondet për zbatimin e masave të ndryshme lë shumë për të dëshiruar. Për momentin, IOM në Tiranë është angazhuar në një projekt i cili mbështet Qeverinë e Shqipërisë në procesin e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit, dhe më në veçanti me masat e tij në lidhje me adresimin e shkaqeve të migracionit, kthimin dhe integrimin me sukses të migrantëve shqiptarë, inkurajimin e lidhjes midis emigracionit dhe zhvillimit si dhe hartimin e një kuadri të plotë ligjor dhe institucional për emigracionin dhe imigracionin.

### ***c) Marrëveshja e Ripranimit me Komunitetin European***

E përballur me një presion të madh emigrimi, Shqipëria nënshkroi marrëveshjen e parë dy-palëshe të ripranimit me Italinë në vitin 1998. Që nga ajo kohë Shqipëria ka nënshkruar dhjetë marrëveshje ripranimi (MR) dhe është në proces nënshkrimi i shtatë marrëveshjeve të tjera.

---

<sup>56</sup>Instituti European i Tiranës [2006]. Raporti për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Migracionin.

<sup>57</sup>Instituti i Diasporës përbëhet vetëm nga katër anëtarë.

Shqipëria është vendi i parë<sup>58</sup> në Europë që ka negociuar dhe nënshkruar një marrëveshje ripranimi me Komunitetin European për kthimin e shtetasve të vet dhe shtetasve të vendeve të treta, kjo si pjesë e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit me BE-në ( marrëveshja zëvendëson marrëveshjet dypalëshe të nënshkruara më parë me shtete të vecanta të BE-së)<sup>59</sup>.

Qeveria Shqiptare është e ndërgjegjshme për rëndësinë që ka zbatimi me sukses i marrëveshjes së ripranimit me BE-në në procesin e MSA, megjithatë nuk duhet të anashkalohen sfidat që po has administrata shqiptare në zbatimin e Marrëveshjes së Ripranimit<sup>60</sup>. Përveç nevojës për burimet dhe mekanizmat e duhura, duhet të adresohet edhe çështja e kthimit dhe e ri-integrimit të qëndrueshëm të shtetasve shqiptarë. Për më tepër, duhen hartuar procedurat e duhura për marrëveshjet e kthimit dhe ripranimit me shtetet e origjinës për të adresuar kthimin e migrantëve të parregullt që vijnë nga shtete të treta por që kanë kaluar tranzit nga Shqipëria.

#### ***d) Menaxhimi i kufirit<sup>61</sup>***

Sipas Raportit të Progresit të Komisionit European në vitin 2006, Shqipëria ka bërë progres në fushën e menaxhimit të kufirit gjatë vitit 2006. Progres është bërë dhe në drejtim të përmirësimit të kontroleve të flukseve migratore në Pikat Kufitare të Kalimeve (PKK). Pajisjet e reja dhe mbështetja logjistike kanë ndikuar në rritjen e efikasitetit të survejimit të kufirit të gjelbër. Është përmirësuar bashkëpunimi midis Drejtorisë së Policisë Kufitare dhe homologëve të saj në shtetet fqinjë. Policia dhe strukturat e saj të kontrollit të kufirit kanë qenë shumë më aktive në parandalimin e kalimit kontraband të mallrave përmes kufirit të gjelbër, si dhe në reduktimin e migracionit të paligjshëm në Greqi.

Drejtoria e Policisë Kufitare dhe Migracionit e ka përshtatur politikën e menaxhimit të kufirit në përputhje me udhëzimet e BE-së për Menaxhimin e Integruar të Kufirit në Ballkanin Perëndimor por strategjia ende nuk është adoptuar. Duhet bërë akoma përpjekje në mënyrë që të gjitha PKK-të e Shqipërisë të plotësojnë standartet Europiane.

#### ***e) Të tjera dokumente lidhur me politikën e migracionit***

Strategjia Kombëtare për Migracionin ka parashikuar një sërë dispozitash për kthimin dhe ri-integrimin e migrantëve shqiptarë, që janë të ngjashme me ato të specifikuara në dokumente të tjera të politikash/strategjish, si p.sh: Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit, Drafti i Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Fëmijëve, Strategjia Kombëtare për Punësimin dhe Trajnimin Profesional, dhe Planet e tyre të Veprimt. Plani i Veprimt për Lëvizjen e Lirë përmban gjithashtu dispozitat për kthimin e shtetasve shqiptarë, dhe ka të bëjë kryesisht me zbatimin e procedurave të ripranimit, ku përfshihet edhe nevoja për trainimin e personelit policor në çështjet e ripranimit.

---

<sup>58</sup>Në marrëveshje të tjera përfshihen Sri Lanka, Macao, Hong Kong, dhe Federata Ruse.

<sup>59</sup>IOM [2006]: Kthimi dhe Ripranimi në Shqipëri.

<sup>60</sup>Neni 81 i marrëveshjes së MSA, thotë se Shqipëria duhet të zbatojë plotësisht Marrëveshjen e Ripranimit KE-Shqipëri.

<sup>61</sup>KE [2006]: Shqipëri 2006 Raport Progres.

Ligji për të Huajt u hartua nga një grup pune i përbërë nga struktura të ndryshme ndër të cilat edhe IOM-i. Projekt Ligji i Ri parashikon dispozitat për verifikimin paraprak dhe trajtimin e migrantëve të parregullt në territorin e Shqipërisë si dhe dispozitat për ndalimin ose largimin e tyre në rastet e parregullsisë. Gjatë kohës së hartimit të këtij dokumenti, Draft Ligji është duke u rishikuar nga Ministria e Drejtësisë.

## **6.4. Kuadri ligjor ndërkombëtar ekzistues në lidhje me migracionin**

### ***Traktatet Ndërkombëtare të Ratifikuara nga Shqipëria:***

- C97 Konventa e Migracionit për qëllime Punësimi 1949, ratifikuar në 02/03/2005
- Konventa për Statusin e Refugjatëve 1951, ratifikuar në 18/08/1992
- Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racial 1965, e ratifikuar në 10/06/1994
- Marrëveshja Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike 1966, ratifikuar në 04/01/1992
- Marrëveshja Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike , Sociale dhe Kulturore 1966, ratifikuar në 04/ 01/1992
- C143 Konventa për Migrantët e Punësuar (Dispozita Shtesë) 1975, ratifikuar në 12/ 09/2006
- Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Discriminimit të Grave 1979, e pranuar në 11/05/1994
- Konventa kundër Torturave dhe Trajtimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Deraduese ose Ndëshkimeve 1984, ratifikuar në 10/06/1994
- Konventa për të Drejtat e Fëmijëve 1989, ratifikuar në 28/03/1992
- Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të të Gjithë Migrantëve të Punësuar dhe Pjesëtarëve të Familjeve të tyre, ratifikuar në 05/06/2007
- Protokollin kundër Kontrabandës së Migrantëve nga Toka, Deti dhe Ajri, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar 2000, ratifikuar në 21 Gusht 2002
- Protokollin për të Parandaluar, Eliminuar dhe Ndëshkuar Trafikimin e Qënjeve Njerëzore Veçanërisht Gratë dhe Fëmijët, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transkombëtar 2000, ratifikuar në 21 Gusht 2002

### ***Konventat e Këshillit të Europës:***

- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, 2/10/1996
- Konventa e Këshillit të Europës për Masat Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, 2005, e ratifikuar në 6/2/2007

## ***Marrëveshjet dypalëshe të punësimit***

Marrëveshjet dypalëshe të punësimit sezonal janë nënshkruar me Gjermaninë (1991), Greqinë (1996) dhe Italinë (1997)<sup>62</sup>.

## ***Marrëveshjet e ripranimit***

Janë në fuqi marrëveshjet e ripranimit me Komitetin European (2005, hyri në fuqi në 1 Maj 2006), me Mbretërinë e Bashkuar (2005), Kroacinë (2005), Bullgarinë, Gjermaninë, Hungarinë, Italinë, ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Rumaninë (2002)<sup>63</sup> dhe Zvicrën.

## **6.5. Shkalla e “ikjes së trurit” dhe politikat përkatëse**

Sipas një studimi nga Qendra për Studime Ekonomike dhe Sociale (Centre for Economic and Social Studies CESS), gjatë periudhës 1991–2005, më shumë se 50% e lektorëve dhe akademikëve të universiteteve dhe institucioneve kërkimore në Shqipëri kanë emigruar nga Shqipëria<sup>64</sup>. Në vitin 2005, shtetet kryesore pritëse për lektorët dhe akademikët shqiptarë ishin SHBA (26.3%), Kanada (18.4%), Itali (13.7%), Greqi (12.9%), Francë (9.7%), Gjermani (6.3%), Angli (2.9%) dhe Austri (2.6%)<sup>65</sup>.

Është llogaritur që çdo vit 2,000 deri në 4,000 studentë shqiptarë largohen për të ndjekur universitetet jashtë shtetit, kryesisht në Itali, Francë, Gjermani, MB, Greqi dhe SHBA. Vetëm në universitetet e Italisë, janë regjistruar rreth 12,000 studentë shqiptarë. Një studim i kryer në vitin 2004 me 181 studentë që kishin mbrojtur doktoraturën ose kandidatë për ta mbrojtur, tregoi se vetëm 56% e atyre që u intervistuan shfaqën dëshirën për tu kthyer në Shqipëri<sup>66</sup>.

Për momentin nuk ekzistojnë politika që të nxitin kthimin e afërt të akademikëve nëpër institucionet shqiptare ku ata punonin dhe trajtoheshin para se të largoheshin nga vendi. Ligji i ri për arsimin e lartë u jep universiteteve mundësinë që të percaktojnë politikat për angazhimin e studentëve, që kanë mbaruar universitetin jashtë shtetit, në programe masterash dhe doktoraturash.

(Shiko seksionin 9 për një përshkrim të Programit të Kthimit të Trurit të UNDP-së ).

---

<sup>62</sup>Qeveria e Shqipërisë [2005]: Përgjigje Pyetësorit për Workshop-in për Migracionin e Punësimit të IOM-it në Shkurt 2005, Zagreb.

<sup>63</sup>ICMPD [2005]: Yearbook on Illegal Migration, Human Smuggling and Trafficking in Central and Eastern Europe, Vienna.

<sup>64</sup>Centre for Economic and Social Studies (CESS) (Qendra për Studime Ekonomike e Sociale) - Qendra Kërkimore për Migracionin, Globalizimin dhe Varfërinë [2006]: UNDP Policy Paper: From Brain Drain to Brain Gain: Mobilizing Albania's Skilled Diaspora.

<sup>65</sup>Ibid.

<sup>66</sup>Ibid.

## 6.6. Rrugët e paligjshme të migracionit dhe politikat për migracionin e parregullt

Migracioni shqiptar në Greqi që nga viti 1990 ka ndjekur tre rrugë kryesore: dy kalimet kryesore njëra nga Kakavija (që të çon në Janinë) dhe tjetra nga Bilishti (që të çon në Kastoria dhe Florina), dhe rruga e shkurtër detare nga Saranda në Korfuz. Një rrugë e katërt kalon përmes pjesës jugore të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë për në Selanik<sup>67</sup>.

Pas miratimit nga Parlamenti Shqiptar i ligjit për ndalimin e mjeteve të lundrimit në Detin Adriatik dhe në Detin Jon në Korrik 2006, rrugët e migracionit të paligjshëm u drejtuan për nga kufiri i gjelbër.

Rrugët kryesore të migracionit të paligjshëm janë:

Shqipëri – ish Republika Jugosllave e Maqedonisë – Greqi me destinacion Shtetet e tjera te Europës Perendimore, Shqipëri – Mal i Zi – Serbi – Slloveni – Itali, Shqipëri – Kosovë (Rep e Serbisë) – Kroaci - Slloveni me destinacion Shtetet e tjera të Europës Perendimore, Shqipëri – Greqi – Itali.

Shtetasit e huaj që janë kapur në kufirin shqiptar janë kryesisht Kineze, Indiane, Turq, dhe Pakistaneze. Pjesës më të madhe të tyre iu është refuzuar hyrja në aeroportin “Nënë Tereza”, Rinas.

## 6.7. Trafikimi i qënieve njerëzore dhe politikat përkatëse

Shqipëria ndonëse është ende vend origjine për trafikimin, nuk është më një vend i rëndësishëm tranziti ose destinacioni. Viktimat shqiptare trafikohen për në Greqi dhe Itali, Mbretërinë e Bashkuar, Francë, Belgjikë, Norvegji, Gjermani dhe Hollandë. Trafikimi brenda vëndit i grave dhe fëmijëve për shfrytëzim seksual është në rritje.

Numri total i viktimave shqiptare që janë identifikuar dhe ndihmuar gjatë periudhes 2000 deri në 2004 ishte 1750<sup>68</sup>. Të miturit përbënin një përqindje të konsiderueshme të viktimave shqiptare që u ndihmuan jashtë shtetit (21.1% ne 2003 dhe 23.6% ne 2004). Të miturit përbënin 100% të viktimave të raportuara për punë, lypje dhe krime të kryera nga të miturit në 2003 dhe 93.2% në 2004. Minoritetet rome dhe egjiptiane përbëjnë numrin më të madh të gjithë viktimave shqiptare. Persona të paafte mendërisht dhe fizikisht përbëjnë një të tretën e viktimave shqiptare të trafikuar për shfrytëzim seksual. Pjesa më e madhe e viktimave shqiptare trafikohen nga persona që i njohin ata ose familjet e tyre dhe që kanë qenë herë pas here bashkëpunëtorë në trafikime (veçanërisht në rastet e trafikimit për punë, lypje ose krime të të miturve). Mënyra e transportimit është kryesisht e paligjshme dhe pa dokumenta ose me dokumente të fallsifikuara. Në vitin 2003, 33.7% e viktimave të trafikuar për shfrytëzim seksual ishin të ri-trafikuar<sup>69</sup>.

---

<sup>67</sup>Russell K., Vullnetari, J., Qendra Kërkimore Sussex për Migracionin [2003]: Migracioni dhe Zhvillimi në Shqipëri, Flete Pune Nr. C5 p.37.

<sup>68</sup>Surtees, R., [2005]: Second Annual Report on Victims of Trafficking in South-Eastern Europe. Regional Clearing Point.

Që nga viti 1999 deri në 2006 IOM iu ofroi ndihmë 90 viktimave shqiptare të trafikuar në Shtetet Anëtare të BE-së<sup>70</sup>.

Në vitin 2006, policia dërgoi në Prokurorinë e Përgjithshme 51 raste të reja trafikimi, e cila investigoi 65 persona për akuza lidhur me trafikimin. Dyzet e tre raste u dërguan në Gjykatën e Krimeve të Rënda, 62 për ndjekje penale dhe 57 dënime për trafikim. Disa officerë policie, punonjës doganash dhe të policisë kufitare u dyshuan të ishin përfshirë në lehtësimin e trafikimit. Shqipëria ratifikoi një marrëveshje dypalëshe me Greqinë për të ndihmuar kthimin e fëmijëve viktimat të trafikimit<sup>71</sup>.

Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2005-2007 u miratua në Korrik 2005. Kjo strategji përmban Strategjinë Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Fëmijëve dhe Mbrojtjen e Fëmijëve Viktima të Trafikimit si dhe Marrëveshjen e Bashkëpunimit për të ngritur një Mekanizëm Kombëtar Referimi për Identifikimin e Saktë dhe Asistencën për Viktimat e Trafikimit Njerëzor.

Plani Kombëtar i Veprimit ka si qëllim që të adresojë bashkëpunimin e dobët midis policisë dhe prokurorisë, masat e pamjaftueshme ndaj policëve, prokurorëve, gjykatësve dhe zyrtarëve të tjerë të përfshirë në trafikim; si edhe më shumë iniciativa të ndërmarra nga qeveria dhe jo nga OJQ-të në fushën e mbrojtjes dhe të parandalimit. Kjo strategji është ndërtuar sipas seksioneve të mëposhtme: Hetimi dhe Ndjekja Penale, Përkrahja dhe Mbrojtja e Viktimave dhe Dëshmitarëve, Parandalimi i Trafikimit dhe Ri-trafikimit, Kuadri i Koordinimeve. Një Njësi Anti-Trafiku është ngritur nën mbikqyrjen e Koordinatorit për Anti-Trafikimin në Ministrinë e Brendshme.

Në vitin 2006 qeveria Shqiptare, me mbështetjen e IOM-it dhe UNODC-së, ndërmori një fushatë për të ofruar shërbime nëpërmjet një linje të posaçme të pandërprerë për të promovuar një migracion të sigurt dhe për të parandaluar trafikimin e qenieve njerëzore. Me mbështetjen e ILO-s, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta zbatoi një program mikro-huaje për viktimat femra në mënyrë që t'u ofrohet ndihmë për të ngritur biznese të vogla, si dhe për të inkurajuar ri-integrimin dhe parandalimin e ri-trafikimit të tyre<sup>72</sup>. Operacione të përbashkëta policore u ndërmorën së bashku me ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Greqinë dhe Malin e Zi nëpërmjet Qendrës Rajonale SECI (Iniciativa për Bashkëpunim mes vendeve të Europës Juglindore) për Luftën kundër Krimit Transkufitar<sup>73</sup>.

---

<sup>69</sup>Surtees, R., [2005]: Second Annual Report on Victims of Trafficking in South-Eastern Europe. Regional Clearing Point.

<sup>70</sup>Banka e të dhënave të IOM për Viktimat e Trafikimit të asistuar.

<sup>71</sup>Departamenti Amerikan i Shtetit, (2007): Trafficking in Persons Report.

<sup>72</sup>Ibid.

<sup>73</sup>ICMPD [2005]: Yearbook on Illegal Migration, Human Smuggling and Trafficking in Central and Eastern Europe.

## 6.8. Refugjatët, azil-kërkuesit dhe personat e zhvendosur brenda vendit dhe politikat përkatëse ekzistuese

Ligji shqiptar parashikon dhënien e statusit të azilantit ose të refugjatit në përputhje me Konventën e Kombeve të Bashkuara të vitit 1951 në lidhje me Statusin e Refugjatëve dhe protokollin e tij të vitit 1967. Qeveria ka ngritur një sistem për të siguruar mbrojtjen e refugjatëve. Sipas këtij ligji, kërkesa për azil duhet të bëhet brenda 10 ditëve duke filluar nga data e mbërritjes në këtë vend dhe vendimi për statusin e azilit duhet të jepet brenda 51 ditëve duke filluar nga data që është bërë kërkesa. Gjatë vitit 2006 qeveria dha azil për gjashtë kërkesa dhe në periudhën Janar-Korrik 2007 dha vendime pozitive edhe për shtatë kërkesa të tjera. UNHCR, përmes një qendre pritëse ndërkombëtare për azil-kërkuesit që menaxhohet nga shteti (Qendra e Pritjes në Babrru), siguron shërbime sociale dhe ligjore, përkujdesje mjekësore, siguracion, dhe mbështetje të kufizuar trajnuese për komunitetin e vogël të refugjatëve dhe asistencë të bashkërenduar përmes një rrjeti OJQ-sh<sup>74</sup>. Në vitin 2006, 54 refugjatë dhe azil-kërkues u akomoduan në Qendrën e Babrrusë<sup>75</sup>. 50 refugjatë dhe azil-kërkues të tjerë edhe pse u akomoduan në ambiente private, jashtë qendrës morrën gjithashtu asistencë mjekësore, ligjore dhe sociale, si dhe një dietë ditore për të përballuar financiarisht jetesën. Të gjithë fëmijët e azil-kërkuesve dhe refugjatëve ndoqën shkollat fillore. Nuk u raportua asnjë rast refuzimi<sup>76</sup>.

Programi i verifikimit paraprak i cili u zbatua nga UNHCR në bashkëpunim me IOM-in, OSBE-në dhe Ministrinë e Brendshme, iu dërgua në mënyrë zyrtare qeverisë në Mars 2006. Sistemi i përzgjedhjes është një metodë operacionale për të identifikuar dhe kanalizuar azil-kërkuesit, migrantët e parregullt dhe viktimat e trafikimit sipas sistemeve dhe procedurave të duhura. Në fund të këtij projekti të përbashkët, u trajnuan 2,000 roje kufiri, oficerë policie dhe nënpunës civil, u rehabilituan 11 qendra tranzit pritëse në PKK kryesore, dhe këto struktura u pajisën me tetë makina dhe pajisje kompjuterike.

Sipas Raportit të Progresit të Komisionit European për Shqipërinë në vitin 2006 kuadri i përgjithshëm ligjor për azil është në përputhje me standartet ndërkombëtare. Pajisjet për përpunimin e kërkesave për azil janë përmirësuar dukshëm dhe tani është krijuar sistemi i verifikimit paraprak. Të gjithë azil-kërkuesit dhe refugjatët do të pajisen me dokumentet e nevojshme. Kohët e fundit janë ndërtuar dy qendra: një për azil-kërkuesit dhe një qendër kombëtare pritjeje për viktimat e trafikimit në Shqipëri<sup>77</sup>.

Në vitin 2007 Shqipëria pranoi tetë ish të burgosur nga Guantanamo të cilët nuk mund të riktheheshin në atdheun e tyre sepse i trembeshin ndjekjes penale dhe torturave. Ish të burgosur nga Kina, Algjeria, Uzbekistani dhe Egjipti për momentin janë strehuar në një qendër pritjeje për refugjatët.

---

<sup>74</sup>Departamenti Amerikan i Shtetit (2006): Human Rights Report.

<sup>75</sup>Të dhënat janë siguruar nga zyra e UNHCR-së në Tiranë, Gusht 2007.

<sup>76</sup>UNHCR (2006): Global Report 2006 – South-Eastern Europe Sub-regional Overview.

<sup>77</sup>Komisioni European [2006]: Albania 2006 Progress Report.

## 6.9. Projektet dhe programet për migracionin dhe zhvillimin

Masa 38 e Planit Kombëtar të Veprimit (shiko seksionin 6.5) kërkon përpunimin e Planit Kombëtar të Veprimit për dërgesat në para të emigrantëve në mënyrë që të promovohet kanalizimi formal i dërgesave të migrantëve shqiptarë për qëllime investimi. Për të mbështetur zbatimin e kësaj mase, IOM-i studioi politikat, masat dhe iniciativat e mundshme që mund të zbatohen nga qeveria shqiptare dhe aktorët e tjerë në mënyrë që të përmirësojnë aspektin pozitiv të dërgesave në para – dhe në veçanti funksionin e tyre si një mjet zhvillimi dhe mjet për zbutjen e varfërisë. Studimi “**Konkurenca për dërgesat në para të migrantëve**” përfundoi në Korrik 2005<sup>78</sup>.

Në bazë të rekomandimeve të studimit të mësipërm të IOM-it, IOM dhe ILO (Organizata Ndërkombëtare e Punës) zbatuan një projekt të përbashkët mbi **Rritja e ndikimit të dërgesave në para të migrantëve në Shqipëri: Krijimi i një sistemi të integruar të dërgesave në para të migrantëve** (1 Tetor 2006 – Qershor 2007). Qëllimi i projektit ishte që të forconte kapacitetet institucionale dhe teknike të qeverisë shqiptare, organizatave ndërkombëtare, agjensive jo-qeveritare, zyrave lokale qeveritare në mënyrë që të rrisin impaktin ekonomik, social dhe politik të dërgesave në para të emigrantëve në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Migracionin (masa 38). Projekti u zbatua me mbështetjen teknike dhe financiare të Ministrisë Italiane të Punëve të Jashtme.

Rezultati kryesor i projektit ishte hartimi i draftit të **Planit Kombëtar të Veprimit për Dërgesat në para të migrantëve**. Plani i Veprimit përmban tetë masa specifike që kanë për qëllim rritjen e impaktit ekonomik dhe social të dërgesave në para të migrantëve në Shqipëri. Ato variojnë nga përmirësimi i mbledhjes së të dhënave mbi dërgesat në para të migrantëve dhe zgjerimi i studimeve për to, deri në përmirësimin e shërbimeve që kanë të bëjnë me dërgesat në para; si dhe në informimin e migrantëve mbi alternativat e transferimit të këtyre dërgesave, kurtimeve dhe investimeve; për rritjen e kapaciteteve të qeverisë shqiptare dhe komuniteteve të migrantëve për të bashkëpunuar nëpërmjet iniciativave transkombëtare për zhvillim.

Drafti i Planit Kombëtar të Veprimit për Dërgesat në para të migrantëve paraqet përpjekjet e kombinuara të 24 institucioneve, ku përfshihen edhe agjensitë qeveritare, bankat private, agjensitë e zhvillimit lokal që operojnë në tregun financiar në Shqipëri, dhe Organizatat Ndërkombëtare që u ftuan për të marrë pjesë në një Grup Pune Ndër-agjensor (IWG) për të përpunuar Planin Kombëtar të Veprimit për Dërgesat në para të migrantëve dhe për të dhënë këshillime për zbatimin e aktiviteteve të projektit. Për momentin ky draft pritet që të miratohet nga Qeveria Shqiptare.

**Programi për Kthimin e Trurit** ( data e fillimit: Shtator 2006) ka si qëllim që të përkrahë krijimin e stimujve të nevojshëm dhe mekanizmave të politikave kombëtare në mënyrë që diaspora shqiptare të angazhohet në mënyrë efikase në zhvillimin ekonomik, administrativ dhe shkencor të vendit. Ky projekt ka si qëllim “kthimin e trurit” në Shqipëri dhe do të mbështetë qeverinë për përgatitjen e kuadrit të politikës për të adresuar këtë çështje.

---

<sup>78</sup>Ky raport është i disponueshëm në adresën [www.iomtirana.org.al](http://www.iomtirana.org.al)

Do të krijohet një bankë të dhënash online për të përmbushur kërkesat e insitucioneve akademike shqiptare, administratës publike dhe sektorit privat me ekspertizën që ofrohet nga diasporat shqiptare.

Programi po zbatohet nga Këshilli i Ministrave dhe partnerët e tij kryesorë qeveritare janë: Kabineti i Kryeministrit, Departamenti i Administratës Publike në Ministrinë e Brendshme, Instituti i Diasporës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Arsimit nëpërmjet financimit të PNUD-it.

Partnerë të tjerë janë:

- Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM)
- Fondacioni i Hapur për Shoqërinë, Skema e Dhënjes së Bursave
- (Open Society Foundation Albania Fellowship scheme)
- Fondacioni “Mjaft!”
- Alb-Student
- Rrjeti i Shoqatës së Studentëve Shqiptare (Albanian Student Association Network).

IOM do të ketë partnerë PNUD-in dhe Fondacionin Soros për zbatimin e komponentit që ka si qëllim kthimin virtual si dhe konsulenca të shkurtra nga Shqiptarët e mërguar.

## **6.10. Aktorë të tjerë të rëndësishëm në fushën e migracionit në vend**

### **Aktorët ndërkombëtare**

*Ambasada Britanike në Shqipëri* mbështet politikën Britanike në Europën Juglindore, duke inkurajuar integrimin e Shqipërisë në strukturat Euro-Atlantike dhe rolin e saj në bashkëpunimin rajonal. Në këtë aspekt ato bashkëpunojnë ngushtë me IOM-in dhe me autoritetet kombëtare për të kufizuar fluksin e migracionit të parregullt dhe për të parandaluar trafikimin e qenieve njerëzore. Rruga Skëndërbeg 12, Tirana, Tel: + 355 4 234973/4/5, Fax: + 355 4 247697

**www.uk.al**

*Cooperazione Italiana allo Sviluppo* (Bashkepunimi Italian për Zhvillimin) **www.italcoop-albania.org** në Itali vazhdon të jetë donatori më i madh bilateral për Shqipërinë prioritetet e së cilës foksohen në përkrahjen e Shqipërisë për anëtarësimin e saj në BE, zhvillimin socio-ekonomik dhe stabilitetin në përgjithësi. Projektet e financuara nga kjo organizatë fokusohen në rehabilitimin e infrastrukturës, përmirësimin e shërbimeve kryesore dhe kushteve socio-sanitare, forcimin e insitucioneve dhe zhvillimin e sektorit privat.

*COOPI – Cooperazione Internazionale* (Bashkëpunimi Ndërkombëtar) **www.coopi.org** është një organizatë jo-qeveritare italiane e krijuar në vitin 1965, që zbaton programe zhvillimi për ndërhyrjet e emergjencës në Afrikë, Amerikën Latine, Azi dhe në vendet e Ballkanit.

### ***Delegacioni i Komisionit European në Shqipëri***

Delegacioni i KE në Shqipëri mbështet përpjekjet e qeverisë shqiptare në procesin e ngritjes dhe zbatimit të një sistemi efektiv për migracionin, azilin, kthimet dhe ripranimet në përputhje me standartet e BE-së dhe ato ndërkombëtare. Rruga e Durrësit, 127/1, Laprakë, Tirana, Tel: + 355 4 228 320, Fax: + 355 4 270 679

***Dorcas Aid International*** [www.dorcas.net](http://www.dorcas.net), është një organizatë Kristiane zhvillimi dhe lehtësimi që zbaton projekte për strehimin/rindërtimin dhe rehabilitimin e infrastrukturës.

### ***Komisioni Ndërkombëtar Katolik për Migracionin***

[http://www.icmc.net/e/programmes\\_operations/present\\_programmes/counter\\_trafficking\\_albania.htm](http://www.icmc.net/e/programmes_operations/present_programmes/counter_trafficking_albania.htm)

Nga viti 1999 deri në 2002 Komisioni Ndërkombëtar Katolik për Migracionin menaxhoi qendrën e parë për viktimat e trafikimit në Shqipëri dhe ofroi mbrojtje dhe asistencë për femrat e trafikuar. ICMC vazhdon të bashkëpunojë me OJQ-të, agjencitë qeveritare dhe ndërqeveritare që adresojnë çështjet e trafikimit të qënjeve njerëzore në Shqipëri. Në vitin 2002, ICMC, dhe Ambasada Britanike zbatuan një projekt pilot, në bashkëpunim me njësinë e anti-trafikut të Policisë së Durrësit duke rehabilituar një njësi policie dhe duke ofruar trainime për shkëmbime informacioni për policinë e anti-trafikut.

### ***Organizata Ndërkombëtare e Punës ( ILO)***

Organizata Ndërkombëtare e Punës në Shqipëri ka si qëllim të rrisë përdorimin e dërgesave në para të migrantëve për investime produktive, për uljen e varfërisë, dhe organizon aktivitete që synojnë uljen e punës së të miturve, si dhe parandalimin e trafikimit të fëmijëve me anë të projektit IPEC. Në kuadër të projektit ILO/MIGRANT, ILO ka bërë komente për ligjin e ri shqiptar të emigracionit, dhe ka hartuar një manual specifik trainimi për Shqipërinë mbi politikën dhe menaxhimin e imigracionit për punësim. Gjithashtu do të zbatohet edhe një aktivitet direkt i cili do t'iu sigurojë viktimave të trafikimit trajnim profesional, mundësi punësimi dhe kredi të vogla<sup>79</sup>.

Korrespondenti Kombëtar: Z. Alfred Topi, Instituti Sigurimeve Shoqërore, Rruga Durrësit 83, Tirana. Tel/Fax:+355/427.02.74, e-mail: [nctirana@abcom.al](mailto:nctirana@abcom.al). IOM Subregional Office for Central and Eastern Europe [www.ilo-ceed.hu](http://www.ilo-ceed.hu)

### ***Organizata Ndërkombëtare për Migracion (IOM) [www.iomtirana.org.al](http://www.iomtirana.org.al)***

Misioni i IOM-it bashkëpunon ngushtë me homologët shqiptarë dhe partnerët ndërkombëtarë për të arritur rezultate konkrete në çdo fazë të procesit të migracionit. Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani i saj i Veprimit është një nga mekanizmat strategjike të krijuar nga qeveria shqiptare në bashkëpunim me IOM-in dhe me ndihmën teknike dhe financiare të BE-së në mënyrë që të krijojë mekanizma efikase dhe afatgjata për menaxhimin e migracionit. Në kuadër të marrëveshjes së ri-pranimit midis Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, IOM është angazhuar të ndihmojë qeverinë shqiptare për të përmirësuar kapacitetet e saj institucionale dhe operacionale, për t'i dhënë shtysë dialogut me vendet fqinje dhe për të forcuar bashkëpunimin kufitar. IOM-i në Shqipëri inkurajon migracionin e rregullt dhe ndihmon në kanalizimin e dërgesave në para të migrantëve për zhvillim lokal.

---

<sup>79</sup>ILO [2006]: Albania Decent Work Country Programme 2006-2007.

Rruga “Brigada e Tetë”, Villa No.3, Tirana, Tel: +355 42 578 36, +355 42 578 37, Fax: +355 42 578 35, E-mail: [iomtirana@iomtirana.org.al](mailto:iomtirana@iomtirana.org.al)

***Shërbimi Social Ndërkombëtar (ISS) <http://www.iss-ssi.org>***

Shërbimi Social Ndërkombëtar (ISS) është një organizatë jo-qeveritare ndërkombëtare e angazhuar që të ndihmojë individë dhe familje që kanë probleme personale ose sociale si rezultat i migracionit dhe lëvizjeve ndërkombëtare.

***OSBE (Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë) [www.osce.org/albania](http://www.osce.org/albania)***

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri i ofron ndihmë autoriteteve shqiptare dhe shoqërisë civile për të promovuar demokratizimin, shtetin ligjor, të drejtat e njeriut dhe për të konsoliduar institucionet demokratike në përputhje me parimet, standartet dhe angazhimet e OSBE-së. OSBE-ja ka projekte në fushat e reformës legjislativë dhe gjyqësore, reformës për pronën, reformës zgjedhore, reformës rajonale administrative, në krijimin e kapaciteteve parlamentare, anti- trafikimin dhe anti-korrupsionin, zhvillimin e medias, promovimin e një qeverisjeje të mirë, zhvillimin e shoqërisë civile dhe asistencë për policinë.

Sheraton Tirana Hotel & Towers, 1st Floor, Sheshi “Italia”, Tirana.

Tel: +355 4 23 59 93, Fax: +355 4 23 59 94.

***Misioni PAMECA në Shqipëri***

Me përkushtim ndaj përsosmërisë në punë, PAMECA do të bashkëpunojë me institucionet shqiptare dhe organizatat partnere që të rritet profesionalizmi dhe të përmirësohen aftësitë drejtuese dhe menaxhuese të Policisë dhe Sistemit të Drejtësisë Penale për të arritur përpajime të qëndrueshme.

Rruga “Murat Toptani”, Qendra e Biznesit “EUROCOL”, P.O. Box 8189, Tirana Tel: +355-4-267700/1, Fax: +355-4-267702.

***Save the Children UK <http://www.savethechildren.org.uk/scuk/jsp/wherewework/country.jsp?ukww=&section=europe&subsection=albania&page=2>***

Save the Children (Shpëto Fëmijët) synon të luftojë trafikimin e fëmijëve në Shqipëri nëpërmjet parandalimit, mbrojtjes dhe integritit. Save the Children ofron mbrojtje dhe mbështetje për gratë dhe vajzat e trafikuar duke siguruar akomodim, ushqim, këshillim psikosocial, përkujdesje sociale dhe mjekësore dhe këshillim ligjor. Save the Children gjithashtu ofron trajnime profesionale dhe gjetjen e vendeve të punës për të ndihmuar gratë dhe vajzat që të ri-integrohen në shoqëri.

***SIDA -<http://www.sida.org>***

Qëllimi kryesor i Bashkëpunimit për Zhvillim me Suedinë është të reduktojë varfërinë duke mbështetur reformat që kanë si qëllim të sjellin Shqipërinë sa më afër ekonomikut dhe politikisht me BE-në. Detyra më e rëndësishme e SIDA-s është të ofrojë ndihmë për të krijuar një administratë të aftë e demokratike, që nënkupton decentralizimin në nivel lokal dhe rajonal, një system të besueshëm ligjor dhe një respekt më të madh për të drejtat e njeriut. Suedia gjithashtu ofron asistencë për mjekësinë, menaxhimin e burimeve njërzore dhe çështjeve gjinore.

**Agjensia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim (SDC) – <http://www.sdc.gov.ch>**

Filozofia kryesore e SDC është të luftojë varfërinë nëpërmjet programeve të pjesëmarrjes, duke krijuar përmirësime të qëndrueshme në jetën e njerëzve duke i angazhuar ata vetë në proces. Qëllimi kryesor i saj është të përmirësojë aksesin në arsim dhe në kujdesjen shëndetësore bazë, të krijojë kushte për ruajtjen e mjedisit, të inkurajojë autonominë ekonomike dhe qeveritare dhe të përmirësojë barazinë në punë.

**Kombet e Bashkuara në Shqipëri [www.un.org.al](http://www.un.org.al)**

**Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara në Shqipëri (PNUD/UNDP)**

**[www.undp.org.al](http://www.undp.org.al)**

PNUD-i mbështet aspirimin e Shqipërisë për integrim në Europën e Bashkuar dhe kontribuon në përpjekjet kombëtare për të arritur Objektivat për Zhvillim të Mijëvjeçarit. Për të identifikuar të metat në institucione dhe në sektorin publik, PNUD-i dhe Qeveria shqiptare po bashkëpunojnë për të zhvilluar mekanizmat dhe stimujt e duhur për “rikthimin e trurit” dhe për angazhimin e diasporës në zhvillimin e vendit. Rr. “Dëshmorët e 4 Shkurtit”, Villa 35, Tirana Tel.: +355 (4) 233148, 233149, 233122, Fax: +355 (4) 232075, 234448

**United Nations Populations Fund UNFPA (Fondi i Popujve të Kombeve të Bashkuara)**

**[www.unfpa.org.al](http://www.unfpa.org.al)**

Programi i UNFPA-s për Shqipërinë për periudhën 2006-2010 do të përqëndrohet tek drejtësia dhe barazia gjinore, popullsia dhe zhvillimet e saj, shëndeti riprodhues dhe të drejtat. Aktivitetet për popullsinë dhe zhvillimin do të bëhen në shkallë kombëtare, aktivitetet për shëndetin riprodhues do të fokusohen në tre zona gjeografike, brenda kontekstit të planeve për zhvillim rajonal në realizimin e objektivave të mijëvjeçarit. Rruga ‘Donika Kastrioti’, Villa No. 1/1, Tirana, **E-mail: [registry@unfpa.org.al](mailto:registry@unfpa.org.al)**.

**UNHCR <http://www.unhcr.org/cgi-bin/texis/vtx/country?iso=alb>**

Në Shqipëri, UNHCR bashkëpunon me qeverinë për të mbrojtur dhe ndihmuar azil-kërkuesit dhe refugjatët. Ky bashkëpunim nënkupton monitorimin e procedurave për përcaktimin e statusit të refugjatit që kryhet nga qeveria, gjetjen e zgjidhjeve afatgjata për personat e përcaktuar si refugjatët dhe akomodimin e përkohshëm të tyre, kryesisht në Qendrën Kombëtare të Pritjes.

**UNICEF <http://www.unicef.org/albania/>**

UNICEF mbështet institucionet e qeverisë dhe ato të shoqërisë civile për të ngritur strukturat e nevojshme për të përmbushur të drejtat e çdo fëmije me anë të politikave sociale, mbrojtjes ligjore dhe informacionit; për të siguruar zhvillimin dhe shëndetin e fëmijëve, mbrojtjen e tyre nga trafikimi, abuzimi me substancë, dhuna dhe HIV/AIDS.

**USAID Albania [www.usaidalbania.org](http://www.usaidalbania.org)**

Programe në lidhje me migracionin që mbështeten nga USAID:

***The Coordinated Action Against Human Trafficking (CAAHT) (Veprimi i Koordinuar kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore – <http://www.caaht.com/>***

Veprimi i Koordinuar kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore përfaqëson një nga programet më të gjera në fushën e luftës kundër trafikimit në Shqipëri.

Ky program gjashtë-vjeçar (2004 deri në 2009), financohet nga USAID dhe zbatohet nga Creative Associates International, Inc. CAAHT është duke nxitur iniciativat e përfaqësuesve të qeverisë lokale dhe shoqërisë civile që të drejtojnë komunitetet e tyre drejt hapave praktike për të ulur trafikimin e shtetasve shqiptare dhe për t'iu dhënë mundësi viktimave dhe personave në rrezik të ndryshojnë mënyrën e jetesës.

***Programi Ndërkombëtar i Asistencës për Trajnim dhe Hetim Kriminal  
The International Criminal Investigative Training Assistance Program (ICITAP)***

Programi Ndërkombëtar i Asistencës për Trajnim dhe Hetim Kriminal i ofron Qeverisë Shqiptare ndihmë për zhvillimin e kapaciteteve për të siguruar shërbime profesionale për zbatimin e ligjit, të bazuara në praktikat më të mira të policimit, respektimin e të drejtave të njeriut dhe shtetit ligjor, që nga viti 1998. ICITAP i ofron mbështetje Ministrisë së Brendshme dhe Policisë së Shtetit Shqiptar. Kjo ndihmë konsiston në projekte për menaxhimin e kufirit dhe anti-trafikimit; luftën kundër krimit të organizuar; përgjegjshmërinë policore dhe menaxhimin e burimeve njëzëre; trajnimet dhe sistemet e menaxhimit të informacionit ku përfshihet edhe TIMS (Sistemi i Menaxhimit të Teknologjisë të Informacionit).

**Aktorët lokalë:**

***Rrjeti “Të gjithë së Bashku Kundër Trafikimit të Fëmijëve” (BKTF) (All Together against Child Trafficking)*** është një koalicion organizatash ndërkombëtare dhe organizatash jo-qeveritare (OJQ). Koalicioni është i angazhuar në parandalimin e trafikimit të fëmijëve në Shqipëri dhe kontribuon me ekspertizë ligjore dhe këshillim të përgjithshëm.

**<http://www.bktf-coalition.org/index2.html>**

Adresa: Blv “Zhan D’Ark” Kulla5, Kt 3, Ap 9, Tirana Tel +355 4 269307

***Qendra për Inicativën Ligjore për Gratë***

Qendra është një projekt i Shoqatës së Grave Juriste e cila u jep mbështetje ligjore viktimave të trafikimit dhe të dhunës, i ndërgjegjëson ato për shkaqet dhe efektet negative të trafikimit te qenieve njerëzore dhe trajnon punonjësit lokale të zbatimit të ligjit në Shqipëri.  
Tel: +355 4 259795.

***Të ndryshëm dhe të Barabartë (Different and Equal) (DandE)*** - është një nga strehat më afatgjata në Tiranë për viktimat e trafikimit. DandE ofron shërbime të drejtpërdrejta ri-integrimi për viktimat e trafikimit. Angazhimi i DandE-se për ri-integrimin, akomodimin dhe shërbime të tjera u japin mundësi vajzave të reja, që kanë vuajtur pasojat shkatërruese të trafikimit, të rifitojnë dinjitetin dhe të rindërtojnë një jetë të lumtur normale. Rr. Jeronim Derada, Nr.55, Ap.2, Tirana Phone & Fax: + 355 4243606  
E-mail: **[different&equal@icc.al.org](mailto:different&equal@icc.al.org)**.

***Shoqata Shpresë për të Ardhmen (Hope for the Future Association)*** ofron ndihmë që nga viti 1999 për ri-integrimin e migrantëve të kthyer. Kjo ndihmë konsiston në mbështetjen për punësimin e tyre nga kompani private, trajnime profesionale, kurse të gjuhëve të huaja, kurse për kompjuter dhe liçencë makine, si dhe shumë shërbime të tjera me karakter social.

Nga projektet e Shpresës, kanë përfituar 1138 individë gjatë periudhës 1999-2006. Bulevardi “Gjergj Fishta”, Kulla 8, Ap 11, Tirana, Albania  
Tel. + 355 4 253 649 Tel/Fax: + 355 4 224 033  
**E-mail: shprese@shprese.org, Web: www.shprese.org**

*Other Vision (Vizioni Tjetër)*, e financuar nga projekti CAAHT (Veprime të Koordinuara Kundër Trafikimit Njerëzor) drejton një qendër residenciale, një çerdhe ditore për komunitetin dhe siguron apartamente për të miturit që janë në vështirësi, ku përfshihen edhe viktimat e trafikimit. Misioni i shoqates është të mbrojë të drejtat e njeriut dhe të rrisë ndërgjegjësimin për grupet në nevojë në Shqipëri.

***Qendra Psikologjike Vatra “The Hearth”***

Është një organizatë jo-qeveritare e angazhuar në luftën kundër trafikimit të grave për shfrytëzim seksual nëpërmjet një sërë aktiviteteve, si rritja e ndërgjegjësimin të publikut dhe kryerja e studimeve për statusin social të grave në Shqipëri dhe trafikimit të qenjeve njerëzore, duke ofruar shërbime si këshillime për femrat e trafikuar në Qendrën Psiko-Sociale Vatra (Hearth Psycho-Social Centre). Rr. Pirro Bisha, Vlorë.

Email: **Q.P.S-Vatra@aul.sanx.net**

Tel/Fax: +355-03-327-509



